

**Fjala përshëndetëse e Komisionerit për të Drejtën e Inforimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi  
në hapje të “27 Case Handling Workshop”  
28-29 shtator 2015, Tiranë**

Të nderuar!

Me lejon t’ju shpreh kënaqësinë për mirëseardhjen në Tiranë të gjithë pjesëmarrësve në “Takimin e 27-të të Punës të Rasteve të Veçanta”.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizon për herë të parë në Shqipëri “Takimin e 27-të të Punës për Rastet e Veçanta”. Ky është aktiviteti më i rëndësishëm në këtë format për të diskutuar dhe ndarë eksperiencat në nivel teknik mes Autoriteteve tona homologe, anëtare të Konferencës Evropiane. Për këtë arsye, shpreh bindjen se përgjatë këtyre dy ditëve atmosfera e punës dhe kontributet e përbashkëta do të sjellin produktin e duhur.

Përgjatë vitit të fundit, **Zyra e Komisionerit ka trajtuar një numër të madh ankesash për një vend të vogël si Shqipëria dhe me një eksperiencë modeste në këtë drejtim. Spektri i tyre është mjaft i gjerë, duke prekur thujtë të gjithë sektorët e zhvillimit ekonomiko-social të vendit.**

Kjo është njëra anë, ana tjetër është se **ndërgjegjësimi i qytetarëve për respektimin e të drejtave të tyre dhe veçanërisht për privatësinë e tyre, mbetet për t’u përmirësuar.**

**Zhvillimi dinamik i teknologjive të informacionit dhe përdorimi i tyre gjithnjë e më masiv, “detyron” Autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale, që së bashku me ligjvënësit dhe me konsensusin e grupeve të interesit, të kenë të njëjtin dinamizëm.** Zyra e Komisionerit, aktualisht është në fazën e identifikimit të mundësisë për përmirësime ligjore, duke ndjekur të njëjtën filozofi si edhe të vendeve me praktika të avancuara e me standarde të larta në mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve.

Agjendën e takimit e kemi konceptuar në mënyrë që t’i japim mundësinë e prezantimit edhe kontrolluesve publikë apo privatë për të prezantuar disa nga praktikatat e tyre më të mira.

Punë të mbarë!